

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Behar Ymeri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Igballe Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit H.B., nga Gjilani, për shkak të veprës penale keqpërdorim i autorizimeve ekonomike nga neni 236 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 - 1.5 të KPK-së, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.M., avokat nga ..., duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.956-a/2015, të datës 22.09.2015 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 03.11.2017, mori dhe shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit H.B., nga babai B. dhe nëna T., e lindur M., i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna e ..., me vendbanim në ..., rr.” ... ”, ka të kryer fakultetin, me profesion ekonomist, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ish drejtor financiar në KRM “ ... ” Sh.a.me seli në Gjilan, shqiptar, shetas i Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nën paragrafi 1.3 të KPPRK-s, i pandehuri i lartcekur:

### LIROHET NGA AKUZA

Sepse nga gjysmë vjetori i dytë i vitit 2009 deri më 31.06.2012 në Gjilan nga pozita e personit përgjegjës dhe drejtorit financiar në KRM “ ... ” Sh.A. në mënyrë të vazhdueshme i ka keqpërdorur autorizimet e veta në ekonomi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për ndonjë person tjetër, përmes përpilimit të dokumenteve me përmbajtje të rreme, me bilance të rreme, me vlerësime të rreme, përmes fshehjes së provave, gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike e ka prezantuar qarkullimin dhe rezultatet e veprimtarisë ekonomike të subjektit

të lartë përmendur afarist në mënyrë të rreme dhe në këtë mënyrë i ka vë në lajthim organet drejtuese në këtë organizatë të biznesit dhe nuk i ka paguar detyrimet tatimore ose detyrimet e tjera fiskale të parapara me ligj, ndërsa mjetet me të cilat i ka deponuar i ka shfrytëzuar në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë, në atë mënyrë që nuk i ka transferuar në fondin sindikal mjetet e grumbulluara nga pagat e punëtorëve në shumë prej 8,603.61 €, por i ka përdorur ato për nevoja të pa njohura të kompanisë pa autorizim të autorizim të sindikalisteve dhe nuk regjistron faturat e dt. 10.12.2008, 09.01.2009, 07.02.2009, 07.03.2009, 07.05.2009, 09.06.2009 dhe 09.07.2009 në shumë të përgjithshme prej 78,070.34 €, akt ky i cili konsiston në pasqyrim jo real të gjendjes së detyrimeve tatimore që për pasoj ka shmangien nga tatimi në shumë të përgjithshme prej 10.768.32 €, sepse mos regjistrimi i faturave reflekton prezantim dhe deklaram jo real të gjendjes financiare të kompanisë, me ç’ rast këtë kompani dhe punëtorët e saj i ka dëmtuar materialisht në shumë të përgjithshme prej 19.371.93 €.

-Me këtë kishte për të kryer veprën penale keqpërdorim i autorizimeve ekonomike nga neni 236 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 - 1.5 të KPK-s,

-E dëmtuara KRM “ ... ” Sh.A. Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

-Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

# ARSYETIM

## **1. Rrjedha e çështjes**

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 22.09.2015, ka ngritur aktakuzën PP.nr. 956-a/15, kundër të pandehurit H.B. nga ..., për shkak të veprës penale keqpërdorim i autorizimeve ekonomike nga neni 236 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2-1.5 të KPK-së.

## **2. Pretendimet e palëve**

Prokurori i Shtetit, Bahtie Ademi në fjalën përfundimtare deklaroi se në këtë çështje penale juridike gjatë seancave të mbajtura gjyqësore janë administruar të gjitha provat materiale, duke iu referuar: Deklaratës së ekspertit financiar G.D.; Aneksit A; Bilancit të Kompanisë Higjena të dt.31.12.2011, Aneksit B, Bilancit të Kompanisë Higjena të dt.31.12.2012; Aneksit C; Listës së kontributeve të ndara për fondin social; Aneksi D, Konto për llogaritëse; Aneksit E, Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AE .nr.29/2015, Ekspertizës financiare. Po ashtu, Prokurori i shtetit i referohet edhe dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar. Konsideron se nga prova e administruara dhe dëshmitë e dëshmitareve është vërtetuar plotësisht se i pandehuri H.B. ka kryer veprën penale keqpërdorim i autorizimeve ekonomike nga neni 236 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2-1.5 të KPK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Pastaj, konsideron se përgjegjësia penale e të pandehurit është vërtetuar me ekspertizën financiare të ekspertit financiar R.B. të dt.15.09.2015, në të cilën ndër të tjera është konstatuar se në periudhën e viteve 2009-2011 drejtor financiar ka qenë i pandehuri H.B. dhe se njëkohësisht ka qenë përgjegjës për pasqyrimin e drejtë të gjendjes, deklarimin dhe menaxhimin e financave. Pastaj, thekson se në këtë çështje penale-juridike përveq ekspertizës së elaboruar është edhe ekspertiza e formuluar nga ekspertët financiar të dt.10.07.2017 dhe si rrjedhojë prokurori konsideron se kemi dy ekspertiza të cilat janë kontradiktore njëra me tjetrën. Po ashtu, Prokurori i shtetit konsideron se nga dëshmia e ekspertit M.A. shihet se ky ekspert vetëm se ka përshkruar të drejtat dhe detyrimet e menaxherit të ndërmarrjeve publike-private përkatësisht të përgjegjësve e me asnjë fakt konkret nuk e ka argumentuar se i pandehuri H. nuk e ka kryer veprën penale, por nga i njëjti vetëm se është komentuar rregullorja e punës së ndërmarrjes, gjë që i ka propozuar gjykatës që mos t'ia falë besimin dëshmisë së këtij eksperti përkatësisht komenteve të tij lidhur me rregulloret e ndërmarrjes. Në fund, prokurori i shtetit konsideron se në tërësi është vërtetuar gjendja faktike, gjykatës i propozon që të pandehurin H.B. ta shpallë fajtor dhe njëherit të njëjtit t'i shqiptoj sanksionin e paraparë ligjor, duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës B.O. në fjalën përfundimtare deklaroi: i bashkangjitem ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe paraqesim kërkesë pasuroro – juridike ndaj të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. S.M. në fjalën përfundimtare deklaroi se pa mëdyshje është vërtetuar pa fajësi e të pandehurit H.B., ngase me asnjë provë nuk është vërtetuar fajësia e tij. Këtë konstatim e bazon në Ekspertizën Materialo Financiare të punuar nga grupi i ekspertëve të fakultetit Ekonomik në Prishtinë, sipas të cilës është konstatuar se i pandehuri H.B., Zyrtar kryesor financiar dhe i thesarit në KRM-Higjena në Gjilan, nuk është zyrtar kryesor përgjegjës në raport me pikat e aktakuzës dhe nuk kemi identifikuar veprime të tejkalimit apo keqpërdorimit të autorizimeve zyrtare, gjithashtu zyrtari kryesor financiar autorizimet i ka pasur të kufizuara dhe ka qenë nën mbikqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv. Pastaj i referohet dëshmisë së dëshmitarit S.Sh. shef i kontabilitetit në Eko-higjena, i cili në dëshminë e tij ka deklaruar se pagesat e faturave apo për realizimin e tyre i lejon shefi i ekzekutivit e jo drejtori financiar, duke sqaruar se përgaditjet e llogarive përfundimtare, bilanceve vjetore i përgadit Zyra e Kontabilitetit pastaj i dorëzohen drejtorit financiar dhe ai i paraqet në shqyrtim të organeve më të larta. Pastaj i referohet dëshmisë së Kryetarit të Sindikates N.Sh., i cili ka deklaruar se për inkasimin e mjeteve, ruajtjen e tyre, shpenzimet e tyre në këto mjete ka çasje vetëm Kryetari i Sindikatës. Mes tjerash mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se mbrojtja e të pandehurit është bazuar në dëshminë e S.Sh., N.Sh., provave materiale, faturat-profaturat, bilancet vjetore, ekspertiza materialo financiare e punuar nga grupi i ekspertëve të fakultetit ekonomik në

Prishtinë, kërkesës për hudhjen e aktakuzës të dt.10.02.2016 dhe provave tjera të cilat provojnë pafajësinë e të pandehurit.

I akuzuari H.B., në fjalën përfundimtare deklaroi: e mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të dorëzuar me shkrim pranë kësaj gjykate, nuk e ndijë vetën fajtorë dhe nga gjykata kërkojë që të më lirojë nga përgjegjësia penale.

### **3. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor**

Gjendjen faktike të lartcekur, gjyqtari i vetëm gjykues e konstatoi pas administrimit të këtyre provave,

- Deklarata e të pandehurit dhe e dëshmitarëve e dhënë në procedurë hetimore për këtë çështje penale;
- Deklarata e ekspertit financiar G.D. nga Austria e dhënë në gjuhën Gjermane me dt.14.07.2015 dhe e vërtetuar nga i autorizuar i gjuhës gjermane;
- Bilanci i kompanisë KRM “ ... ”, Sh.A.i dt.31.12.2011, bilanci i kompanisë KRM “ ... ”, Sh.A.dt.31.12.2012;
- Lista e kontributeve të ndara për fondin social, konto për llogari të fundit KMDK Sh.a,
- Aktvendimi i Gjykatës së Apelit nr. AE.nr. 29/2015,
- ekspertiza financiare e ekspertit financiar R.B. e dt.15.09.2015,
- Ekspertiza e grupit të ekspertëve nga fakulteti ekonomik në Prishtinë e dt. 10.07.2017.

### **4. Elementet e veprës penale**

Bazuar në një gjendje të tillë të fakteve, gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit H.B. nuk manifestohen elementet qenësore të veprës penale keqpërdorim i autorizimeve ekonomike nga neni 236 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2-1.5 të KPK-së.

Sipas kësaj dispozite ligjore, këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “Personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për organizatën e biznesit ose personin juridik në të cilin është i punësuar apo organizatën tjetër të biznesit ose për personin juridik nëse ai kryen ndonjë prej veprave të mëposhtme: 1) Krijon apo mban fonde të palejuara në Kosovë ose në çfarëdo juridiksioni tjetër; 2) Me përpilimin e dokumenteve me përmbajtje të rrejshme, me bilance të rreme, me vlerësime apo inventarizim apo me prezentim tjetër të rremë a me fshehjen e fakteve në mënyrë të rreme e prezenton lëvizjen e mjeteve ose të rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim organet drejtuese në organizatën e biznesit apo në personin juridik gjatë vendimmarrjes lidhur me punët e qeverisjes; 3) Nuk i paguan mjetet nga detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera fiskale në Kosovë të përcaktuara me ligj; UNMIK/RREG/2003/25 Gazeta zyrtare 6 korrik 2003 257 4) Mjetet me të cilat disponon i shfrytëzon në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë ose 5) Në mënyrë tjetër e cenon rëndë ligjin apo rregullat e afarizmit lidhur me rregullimin, përdorimin apo administrimin e pasurisë”.

### **5. Vlerësimi dhe analizimi i provave**

Gjyqtari i vetëm gjykues pas analizimit me shumë kujdes të gjitha provave të administruara në seancat e mbajtura në këtë shqyrtim gjyqësor, ka ardhur në përfundim se duhet t’i falet besimi i plotë Ekspertizës së grupit të ekspertëve nga fakulteti ekonomik në Prishtinë të dt.10.07.2017 dhe deklaratës së Ekspertit financiar M.A. të dhënë në seancën gjyqësore në këtë gjykate me datën 27.09.2017 sipas të cilës është konstatuar se nuk është gjetur ndonjë dokument kontabël apo operativ, urdhëresë, vendim apo pagesë që do të mund të klasifikohej si keqpërdorim i autorizimeve ekonomike, gjithnjë duke iu referuar përshkrimit të detyrave të punës. Po ashtu sipas këtij konstatimi është konstatuar se i akuzuari si zyrtar kryesor nuk ka qenë përgjegjës në raport me pikat e aktakuzës, dhe nuk janë identifikuar veprime të tejkalimit apo keqpërdorimit të autorizimeve zyrtare, deklaratës së të pandehurit të dhënë gjatë këtij procesi penal me të cilën ka mohuar në tërësi se ka kryer veprën

penale e cila i vihet në barrë. Nga deklarata e të pandehurit rezulton se i pandehuri nuk i ka keqpërdorur autorizimet e tija gjatë kohës që ka punuar në kompaninë KRM ..., me saktësisht prej pjesës së dytë të vitit 2009 deri ka fundi i vitit 2011, e cila deklaratë është në harmoni të plotë me Ekspertizën e grupit të ekspertëve nga fakulteti ekonomik në Prishtinë dhe deklaratën e Ekspertit financiar dr. M.A.. Gjykata, po ashtu, i analizoi me kujdes edhe dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna gjatë këtij procesi gjyqësor, ku besimin ia dha dëshmisë së dëshmitarit N.Sh.-kryetar i Sindikatës sipas të cilës është konstatuar se i akuzuari nuk ka pas kompetenca në inkasimin e mjeteve të punëtorëve dhe për ruajtjen e tyre si dhe për shpenzimet e tyre. Kjo kompetencë sipas kësaj dëshmie rezulton se ka qenë ekskluzivisht e Kryetarit të Sindikatës, ku edhe ka të deponuar nënshkrim në bankë. Gjykata besimin e plotë kësaj dëshmie ia fali sepse dëshmia e dhënë është në harmoni të plotë me provat e prezantuara me ekspertizën e eksperteve financiar të shënuar më lartë rezulton se i akuzuari nuk ka pas kompetenca dhe nuk ka prova që justifikojnë mënyrën e përdorimit të tyre. Konkretisht nuk ka prova që këto mjete janë menaxhuar nga i akuzuari apo i njëjti i ka tërhequr nga llogaria bankare dhe i ka destinuar diku tjetër apo i ka përdor për ndonjë qëllim tjetër. Gjykata besimin e plotë ia dha edhe dëshmisë së dëshmitarit S.Sh., Shef i kontabilitetit në ..., i cili ka sqaruar se pagesat e faturave dhe realizimin e tyre i lejon shefi i ekzekutivit e jo drejtori financiar. Gjykata besimin e plotë ia dha kësaj deklarate sepse edhe kjo deklaratë është në harmoni me ekspertizën e eksperteve financiar të shënuar më lartë. Gjykata nuk ia fali besimin dëshmime të dëshmitarëve B.O., S.R., G.Sh. si dhe ekspertizës së ekspertit financiar R.B., pasi që të njëjtat janë në kundërshtim me provat të cilave kjo gjykate ia ka falë besimin e plotë: Ekspertizën e grupit të ekspertëve nga fakulteti ekonomik në Prishtinë te dt. 10.07.2017 deklaratës së Ekspertit financiar M.A. të dhënë në seancën gjyqësore në këtë gjykate me datën 27.09.2017, deklaratën e dëshmitarit N.Sh. dhe deklaratën e dëshmitarit S.Sh.. Nga e tërë ajo që u tha më lartë, si provë relevante, duke mos i mohuar as provat tjera të shënuara më lartë, gjykata mori për bazë ekspertizën e grupit të ekspertëve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës nga e cila ekspertizë konstatoj se i pandehuri H.B. ka vepruar konform detyrave punuese të përcaktuara me aktet ligjore e nënligjore që e rregullojnë fushëveprimin, kompetencat dhe përgjegjësitë në këtë ndërmarrje.

#### **6. Vendimi për lirim e të akuzuarit nga akuza**

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në nenin 364, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 të KPP-së, gjyqtari e liroi nga akuza të pandehurin H.B., për kryerjen e veprës penale keqpërdorim i autorizimeve ekonomike nga neni 236 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2-1.5 të KPK-së

#### **7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike**

Duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPRK-s, gjyqtari i vetëm gjykues ka vendosur që të dëmtuarin KRK “ ... ” në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest civil.

#### **8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar në nenin 454 paragrafi 1 të KPP. Andaj duke u bazuar në të lartcekura dhe në kuptim të nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

Departamenti i përgjithshëm

Me datë 03.11.2017

**Sekretarja Juridike**

Igballe Azemi d.v

**Gjyqtari**

Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

